



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere
Mbledhja nr.18/24
Prishtinë, më 9.10.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Mergim Lushtaku, Enver Haliti, Duda Balje, Jeta Statovci, Abdullah Hoti, Pal Lekaj, Visar Korenica dhe Eman Rrahmani.

Mungoi: Ferat Shala.

Të ftuarit: Evetar Zeqiri, CEO, KOSTT, Liza Marku, anëtare bordi, KOSTT, Ajrina Gashi-Hamdiu, anëtare bordi, KOSTT, Mimoza Byqmeti, sekretare, KOSTT, Shaban Neziri, KOSTT, Nebih Haziri, zyrtar kryesor financiar, KOSTT.

Pjesëmarrësit tjerë: Sami Gashi, GP LVV, Elsa Krasniqi, GP LVV, Festim Bytyqi, këshilltar, GP AAK, Nexhmije Ahmeti, zyrtare për media, Kuvend, Lulëzim Kelmendi, praktikant, Kuvend, Anduena Shtavica, GP LDK, Egzona Terdovci, këshilltare GP LVV.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Frina Kabashi, praktikante ,D+.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më datë: 25.9.2024;**
- 3. Votimi i Raportit vjetor të punës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2023;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrimin e pronarëve përfitues;**
- 7. Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të KOSTT SH. A për vitin 2023;**
- 8. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2023;**
- 9. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, konstatoi qe me shumicë votash, komisioni miratoi Rendingun e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më: datë 25.9.2024;

Kryetari, konstatoi qe me shumicë votash, komisioni miratoi procesverbalin e datës 25.9.2024.

3. Votimi i raportit vjetor të punës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2023;

Kryetari, njoftoi deputete se për këtë pikë të rendit të ditës debati është konsumuar, por ka mbetur vetëm votimi. Pasi e hodhi në votim, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2023.

- 4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje;**

Kryetari, Projektligji nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr.05/L-087 për kundërvajtje, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se zbatimi i Projektligjit 08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr.05/L-087 për kundërvajtje nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke nënkuptuar se të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky projektligj, do të mbulojnë nga ndarjet buxhetore, të parapara me Ligjin Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 si dhe vlerësimeve për vitet 2024-2025, për Zyrën e Kryeministrit dhe ministrinë.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr.05/L-087 për kundërvajtje, nuk përmban kosto shtese buxhetore, për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta, me Ligjin nr.05/L-087 për kundërvajtje, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë;
5. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat;**

Kryetari, Projektligji nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe komisioni ka dërguar raportin me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se zbatimi i Projektligjit nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, (duke nënkuptuar se të gjitha aktivitetet të cilat dalin nga ky projektligj, do të mbulohen nga ndarjet buxhetore të parapara me Ligjin me Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 si dhe vlerësimeve për vitet 2024-2025, për Zyrën e Kryeministrit dhe ministratë

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, nuk përmban kosto shtese buxhetore, për Buxhetin e Republikës së Kosovës;

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë

6. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente i Komisionit funksional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrimin e pronarëve përfitues

Kryetari: Projektligji nr.08/L-265 për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, është shqyrtuar nga Komisioni Funkcional për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe komisioni ka dërguar raport plotësues me amendamente.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, në cilësinë e Komisionit të përhershëm, deklarohet për koston shtesë të Projektligjit dhe amendamenteve, dhe raportin me rekomandime e procedon tek Komisioni funksional.

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, vlerëson se zbatimi i Projektligjit nr.08/L-265 për Regjistrin e Pronarëve Përfitues, do të ketë kosto shtesë buxhetore në shumë prej 96,776 euro për vitet 2024-2025 si dhe shtim të numrit të punëtorëve për 6 pozita të reja, mjete dhe pozita të cilat nuk janë të planifikuara me Ligjin me Nr.08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 si dhe vlerësimeve për vitet 2024-2025 për MINT, përkatësisht për nënprogramin e Regjistrimit Kosovar të Biznesit si zbatues i këtij projektligji. Kostoja shtese ndërlidhet me administrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues, ku sipas MINT, parashihet punësimi i 6 zyrtarëve të rinj.

Kryetari, konstatoi që me shumicë votash, Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues përmban kosto shtese buxhetore, por të përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
2. Amendamentet e raportit plotësues të propozuara nga Komisioni Funkcional për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë;

7.Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të KOSTT SH. A për vitin 2023;

Kryetari, njoftoi komisionin se në bazë të nenit 13, paragrafi 5 të Ligjit nr. 05/L-085 për Energji Elektrike, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut, i dorëzon Kuvendit të Republikës së Kosovës, Raportin vjetor, më së largu deri më 30 qershor të vitit aktual, për vitin paraprak.

Lidhur me këtë ai ftoi përfaqësuesit e Bordit të KOSTT-it për të prezantuar raportin vjetor për vitin 2023.

Liza Marku, njoftoi komisionin se në mungesë të kryesuesit të bordit, për arsye të përfundimit të mandatit, si anëtare e bordit prezanton raportin vjetor për vitin 2023, si një vit sfidues për shkak të ballafaqimit me krizën financiare dhe energjetike e cila e ka kapluar vendin dhe më gjerë.

Fillimisht, raporti përmban një përmbledhje të aktiviteteve, rezultateve kryesore të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut, në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive për vitin 2023, duke përfshi krahasimet e aktiviteteve në planin e biznesit, planin vjetor dhe shkallen e zbatimit të planit të biznesit.

Viti 2023 është përmyll me arritjet në largimin shumëvjeçarë të furnizimit me energji elektrike për komunat veriore të Kosovës.

Në vazhden e bashkëpunimit me OSK të Shqipërisë dhe Kosovës, si aksionarë të ALPEX-it, KOSTT-i ka punuar në projekt i cili nxit investime të reja në gjenerimin, transmetimin e energjisë elektrike në Kosovë e Shqipëri duke mundësuar një shfrytëzim efikas të burimeve energjetike të të dy vendeve.

Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunim të tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike në të cilën marrin pjesë disa vende të Evropës Juglindore përfshirë këtu edhe Kosovën, është një hap që përfaqëson një zgjerim të sistemit evropian të energjisë me vendet që nuk janë pjesë e BE-së.

Përmes bashkëpunimit shumëvjeçarë të Kosovës dhe fondit të sfidave të njëvjeçarit – MCC në kuadër të programit kompakt synohet instalimi i një sistemi të ruajtjes së energjisë me bateri me kapacitet 170 Megavat në vlerë prej 180 milionë euro nga e cila shumë KOSTT-i do të përfiton kapacitet 45 Megavat në vlerë prej 42.6 milionë euro.

Gjithashtu, në funksion të zgjerimit të shërbimeve dhe në mbështetje të Bankës Botërore KOSTT-i ka aplikuar për grante për projektin Ballkan Digital Highway që përfshin 4 vende të Ballkanit Perëndimor dhe është në 4 faza.

Faza 1 përfshin studimin e fizibilitetit dhe kjo ka përfunduar në vitin 2023.

Përprojekjet e KOSTT-it janë të orientuara drejt realizimit të objektivave strategjike të cilat janë në përputhje të plotë me rolin dhe misionin e KOSTT-it.

KOSTT-i ka zhvilluar infrastrukturën e operimit të sistemit të tregut dhe me përgatitjet për sfida të reja me të cilat do të përballon në të ardhmen vazhdon trendin, e performimit pozitiv dhe dëshmon të mbetet një organizatë efektive dhe e qëndrueshme.

Gjatë vitit 2023 në KOSTT ka vazhduar puna në grupet punuese për të mundësuar implementimin e marrëveshjes së bllokut rregullues të sistemeve energjetike – Kosovë – Shqipëri, blloku AK, marrëveshje

kjo që i obligon palët që bashkërisht të punojnë në operimin e bllokut të përbashkët sipas detyrimeve që dalin nga marrëveshja si dhe në harmoni me kodet nacionale të rrjetit.

Kryetari, konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit votimi i kësaj pike shtyhet për mbledhjen e radhës.

8.Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2023;

Kryetari, konstatoi se për shkak të mungesës së kuorumit kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për mbledhjen e radhës.

9.Të ndryshme.

Kryetari, pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë ndonjë çështje për të ngritur në këtë pikë. Meqë nuk pati e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Armend Muja,

Kryetar i Komisionit